

NUK NJOHIM



DALLIME

TË BARABARTË PARA LIGJIT

KALTRINA (14), FLORIAN (14), MILOT (14), RINESA (13), AGNESA (13), FATLUM (14), ÇLIRIM (13)




Demokracia është...

Rina është një vajzë, e cila vijon mësimin në shkollën fillore „Halil Alidema“, në Pozheran. Ajo si fëmijë, ka të drejtën e lojës, të drejtën e shprehjes së lirë, të drejtën e shkollimit, etj. Të gjitha këto të drejta, ajo dhe të gjithë fëmijët e tjerë i kanë të garantuara me ligj. A thua vallë, cila formë e qeverisjes na mundëson këto të drejta?


Demokracia është formë e qeverisjes, në të cilën i gjithë populli i ka të drejtat e barabarta. Përveç të drejtave të barabarta, elemente të tjera të rëndësishme në shtetet demokratike janë: shprehja e lirë e mendimit, toleranca, respekti, solidariteti, etj.

Secili prej nesh ka dëshira të ndryshme për gjëra të ndryshme. Për shembull, ne në grupin tonë, kur diskutuam rreth lëndëve mësimore që na pëlqejnë, vërejtëm se secili nga ne kishte preferenca të ndryshme. Shembull tjetër është edhe me profesionet që dëshiro-

jmë t'i kemi në të ardhmen. Pra, në demokraci kjo llojllojshmëri lejohet, pranohet dhe respektohet. Vendi ynë Kosova është vend demokratik me sistem parlamentar. Populli në procesin zgjedhor i voton deputetët si përfaqësuesit e tij. Ne jemi ardhmëria e Kosovës, prandaj duhet të mësojmë shumë, të përkushtohemi dhe të bashkëpunojmë, në mënyrë që vendi ynë të përparoj.



Shkolla, vendi ku ne marrim dije



Përfaqësuesit e popullit



Autorët e artikullit

NDARJA E PËRGJEGJËSIVE

ARI (13), GENTRIT (13), SAMIRE (13), FAZILE (13), EDONA (13), MAJLINDA (13), ALMA (13), BLEND (13)



Ky artikull flet për Ndarjen e Pushtetit si dhe rëndësinë e Kuvendit në jetën tonë


Ndonëse jam 13 vjeçare, unë tashmë jam mësuar dhe di si ta ngas veturën. Mirëpo, unë asnjëherë nuk dal në trafik me veturë. A e dini pse? Sepse unë nuk kam të drejtë të marrë patentë shoferin derisa të arrij moshën 18 vjeçare. Po kush ka vendosur kështu? Kështu ka vendosur Kuvendi i Kosovës, përmes ligjit të miratuar për patentë shofer. Sipas këtij ligji, të gjithë jemi të barabartë në marrjen e patentë shoferit, mirëpo mbi moshën 18 vjeçare.

Unë e respektoj këtë ligj dhe çdo ligj tjetër. Nëse nuk do ta bëja këtë gjë, atëherë unë do të veproja kundër vetes, sepse ligjet janë miratuar për të rregulluar jetën time dhe të të gjithë të tjerëve. Prandaj, Kuvendi ka kaq rëndësi për ne. Ligjet që miratohen aty nga deputetët, ndikojnë shumë jetën tonë.

Duhet theksuar se Kuvendi përfaqëson Pushtetin Legjislativ. Çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë se në demokraci ndahet pushteti në mes të institucioneve demokratike. Përveç Kuvendit, degë tjetër e pushtetit është Pushteti Ekzekutiv, që përfaqësohet nga Qeveria, si dhe Pushteti Gjyqësor që përfaqësohet nga Gjykata.

Pyetja e parë që na vie në mendje është: „Pse ekziston ndarja e pushtetit“? Sigurisht se edhe në jetën e përditshme është më e lehtë t'i ndajmë punët. Nëse mbetet vetëm një njeri për ta marrë përgjegjësinë, atëherë ai do të kishte vështirësi. Mirëpo, me ndarjen

e punëve, të gjithë do të ndiheshim mirë dhe të barabartë. Prandaj, edhe institucionet i ndajnë punët në mes vete. Në këtë mënyrë arrihet balanca. Deputetët në anën tjetër janë përfaqësuesit tanë, andaj ne duhet të jemi të kujdesshëm kur ua besojmë votën tonë atyre.



Kushtetuta, akti më i lartë juridik i një shteti



Grupi që me shumë dashuri shkroi këtë artikull

NE DHE QYTETARIA AKTIVE

EDI (13), EDISON (13), ALBONIT (12), HALIDE (HALIDE (13), GENTRIT (12), MIRLINDA (13), ARDIT (13),
BESARTA (13)

Se çka është peticioni, referendumi dhe tubimi publik dhe cila është rëndësia e tyre në demokraci, lexojeni artikullin tonë që ta kuptoni

Peticioni është kërkesë me shkrim. Ne si nxënës e njohim si fletëpalosje që qytetarët e nënshkruajnë për ndonjë çështje për të cilën janë të pakënaqur. Për të dërguar një peticion, duhen më së paku 10.000 nënshkrime. Pasi që mblidhen të gjitha nënshkrimet, atëherë personat që e kanë marrë iniciativën për peticionin në fjalë, e dërgojnë atë në institucionet përkatëse. Pastaj, se a aprovohet apo jo kjo iniciativë, mbetet përgjegjësi e këtyre institucioneve. Të drejtën për të nënshkruar peticion e gëzojnë qytetarët të cilët jetojnë në vende demokratike.

Kjo është një ndër format përmes së cilës qytetarët mund t'i shfaqin brengat e tyre.



Nga qytetarët aktiv, për qytetarët aktiv. Shumë informata iu presin në artikullin tonë



Unë jam Edi dhe do t'iu tregoj më shumë për tubimet publike dhe rëndësinë e tyre në demokraci

Si të jesh qytetar aktiv? Ka shumë mënyra për të qenë aktiv dhe ju të gjithë mund të jeni të fillë

Referendumi është formë e vendimmarrjes e cila hyn në kuadër të demokracisë së drejtpërdrejtë. Kjo formë është forma më e vjetër dhe më e njohur e vendimmarrjes së qytetarëve në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në referendum, është populli ai i cili i merr vendimet. Pra, vendimet merren direkt nga ana e popullit dhe jo nga përfaqësuesit e tij.

Si p.sh. në shtetin e Zvicrës, të gjitha vendimet merren përmes referendumit. Qytetarët janë ata të cilët vendosin drejtpërdrejt.

Ndërsa, në Kosovë, që nga pas lufta të gjitha vendimet janë marrë nga përfaqësuesit e popullit dhe nuk ka pasur asnjë referendum deri më tash.


Të dashur shokë e shoqe, ne sot mësuam për qytetarinë aktive dhe për disa forma se si mund të jemi ne aktiv. Po ashtu, mësuam edhe për tubimet publike, për të cilat do t'iu tregojmë në vijim. Tubimet publike janë shumë të rëndësishme për të gjithë qytetarët e Kosovës. Përmes tubimeve publike, qytetarët mund të dalin dhe të shprehin qëndrimet e tyre rreth një çështje të caktuar, shumë me rëndësi për popullin.

Këto tubime kanë një vlerë të madhe, sepse qytetarët kanë të drejtë të flasin dhe të ngrisin zërin e tyre. Këtë e mundëson demokracia. Për këtë arsye, populli udhëheq në demokraci. Qytetarët janë ata të cilët marrin vendime dhe këtë e bëjnë kur qëndrojnë të bashkuar dhe i ndihmojnë njëri-tjetrit.



Kurse, unë jam Halidja dhe do t'iu informoj më shumë për rëndësinë e referendumit

Bëhu aktiv edhe ti, ashtu sikurse edhe kërkohet në demokraci



Një fjalë e urtë popullore thotë: „Një pikë uji nuk mund ta lëvizë gurin e mullirit“. Nga kjo kuptojmë që vetëm një qytetar nuk mund të bëj ndryshim pa ndihmën e të tjerëve

Demokraci do të thotë shumë më tepër sesa zgjedhje të lira dhe ndarje të pushtetit, ndonëse ato janë pikënisja e saj.

Pushtetin në shoqëritë demokratike e ka populli. Këtë pushtet, populli ua beson përfaqësuesve apo deputetëve të cilët nuk duhet të abuzojnë me të. Në vendet demokratike, ky besim arrihet përmes transparencës së punës të përfaqësuesve të popullit, si dhe lirisë së qytetarëve që të luajnë rol të rëndësishëm në vendim-marrje.

Ne e dijmë që angazhimi qytetar në marrjen e vendimeve është një proces i vazhdueshëm dhe që për qëllim ka mirëqenien e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Pa marrë parasysh shpejtësinë e kryerjes së ndonjë veprimi, qytetarët nuk duhet të ndalen së punuari për të mirën e vendit tyre. E këta qytetarë, të cilët punojnë dhe mundohen gjithmonë për mirëqenie të përbashkët, ne i njohim si qytetarë aktiv. Sipas meje

Besartës dhe shokut tim Arditit, qytetaria aktive është kur njerëzit dalin për të bërë aktivitete të ndryshme. Të pastrojnë vendin ku jetojnë, t’iu dalin në ndihmë personave të varfër, pa dallim feje, etnie, race, apo gjinie, etj. Duke u munduar kështu, që gjithmonë të sjellin ndryshime për të mirën e gjithë komunitetit. Qytetarët aktiv janë ata të cilët gjithmonë kërkojnë më shumë nga shoqëria dhe vetja e tyre.

Një arsimtar i yni, ka kërkuar nga ne nxënësit që të dalim dhe ta pastrojmë përmendoren në Pozheran që quhet „Mejdi Korrani“. Pa dyshim, që ky akt nuk ishte vetëm për të mirën e arsimtarit tonë. Ky ishte një hap shumë i vogël nga ne, por që kishte vlerë shumë të madhe për të gjithë.


Ne këtu e kuptuam se ç’është ndjenja e komunitetit dhe sa e rëndësishme është pjesëmarrja e secilit. Prandaj, ndryshimet e mëdha nganjëherë nisin me ide shumë të vogla.



Qytetarët aktiv kur është nevoja nënshkruajnë peticione



Po ashtu, qytetarët aktiv kujdesen për ambientin e tyre



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Halil Alidema“
Klasa: VIII-2
Vendi: Pozheran, Viti